



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:247616
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05438434

C.nr.2410/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.. Sh.. nga Gj.. te cilën e përfaqëson sipas autorizimit F.. Q., avokat nga P.. kundër të paditurës K.. Gj.. i K.. me seli në P.. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.. M., jurist, me objekt të padisë kompensim i dëmit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 07.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.. Sh., nga Gj.. dhe **DETYROHET** e paditura K.. Gj.. i K.. me seli në P., që paditëses në emër të dëmit material dhe jo material, për privim të pa të drejtë nga liria, për kohën e kaluar në arrest shtëpiak, ne kohëzgjatje prej 60 ditë (gjashtëdhjetë) ditëve, nga data 22.03.2016 e deri më datën 21.05.2016, t'ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

Në emër të dëmit jo material

- a) Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit si dhe frikës së përjetuar, shumën prej 1,800.00 €.

Në emër të dëmit material

- b) për fitimin e humbur, gjatë heqjes së lirisë për shkak të pamundësisë së sigurimit të ardhurave shumën prej.....1,257.64 €.
- c) Në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurë penale në emër të mbrojtjes nga avokati, shumën prej.....5,900.00 €.

II. DETYROHET e paditura që paditëses për pjesën e aprovuar të padisë t'ia paguaj kamatën prej 8%, për dëmin jo material kamata do të rrjedh nga data e marrjes së aktgjykimit 07.03.2024 kurse për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë 17.07.2019 e deri në

pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej përgjithshme 524.00 €, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses M.. Sh.. nga Gj., mbi shumat e aprovuara, dhe atë: për dhimbjet shpirtërore për cenim të autoritetit, nderit dhe frikës së përjetuar shumë prej 18,200.00 €; për fitimin e humbur në shumë prej 54, 856.00 €, si të pa bazuara.

A r s y e t i m

I. Kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja M.. Sh.. nga Gj.. përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 17.07.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensim të dëmit si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë. Fillimisht sipas padisë fillestar, si pjese e padisë në cilësi të palëve paditëse, kanë qenë edhe familjarët e ngushtë të paditëses M.. Sh... Përmes parashtrësës së datës 06.10.2023, i autorizuari i paditësve është tërhequr nga kërkesëpadia në emër të I.. Sh..., bashkëshort i tani me paditëses, dhe nga kërkesëpadia në emër të A.., A.. dhe E.. Sh., fëmijët e paditëses, M.. Sh...

Paditësja në padi si dhe gjatë deklarimeve të dhëna në seancat gjyqësore, përmes të autorizuarit të tij av. F.. Q.. nga P., ka theksuar se Prokuroria Themelore në Gjilan, ndaj paditëses fillimisht ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, e me pas ka ngritur aktakuzë, me dyshimin se e njëjta ka kryer veprën penale në bashkëkryerje: "trajtim i pa ndërgjegjshëm mjekësor, nga neni 219 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës. Si pasojë e arrestit shtëpiak e me qëllim të sigurimit të saj si rezultat i procedurës penale të iniciuar, e njëjta ka theksuar se ka qëndruar në arrest shtëpiak, për periudhën kohore nga data 22.03.2016 e deri më datën 21.05.2016. Pavarësisht procedurës së zhvilluar penale, paditësja sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilani, të datës 25.05.2017, është liruar nga akuza e cila i është vënë në barrë, ku me pas vendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e cila e ka refuzuar ankesën prokurorit duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan. Më pas Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, me datën 27.03.2018, ka marrë aktgjykim me të cilën ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan.

Ka theksuar se si pasojë e arrestimit dhe publikimeve të shumta të cilat i janë bere në medime të ndryshme, ka pësuar dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të nderit, autoritetit dhe reputacionit të mirë për shkak të pozitës së punës si gjinekologe, po ashtu i janë cenuar liritë dhe të drejtat e personalitetit si dhe njëherit ka përjetuar frikë. Tutje ka theksuar që gjatë kohës sa ka qenë e privuar nga liria, ka pasur dëm material që konsiston në fitimin e humbur për shkak të pamundësisë së sigurimit të të ardhurave, për faktin se i është dashur ta mbylle ordinancën private për shkak të dëmtimit të reputacionit personal dhe profesional si mjeke e fushe së gjinekologjisë si dhe dëm material në emër të angazhimit të avokatit mbrojtjes në procedurë penale, në shumë përgjithshme prej 5,900.00 euro.

Në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë të gjitha pretendimeve dhe theksimeve përgjatë seancave kurse pas pranimit të ekspertizave nga lëmia financiare, i autorizuari i paditëses ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë për të gjitha format e dëmit material dhe jo material, me propozim për gjykatën që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të aprovet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura ne përgjigjen e dhënë në padi, nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë sa i përket paditëses M.. Sh., por e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadisë. Në raport me paditësit tjerë, I. Sh., A.. Sh., A.. Sh., dhe E.. Sh., e ka kundërshtuar në tërësi bazën juridike të kërkesëpadisë për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv për të qenë palë në procedurë, me theksimin se paditësit e lartpërmendur nuk kanë qenë në arrest shtëpiak, dhe rrjedhimisht të njëjtëve nuk u takon kompensimi bazuar në dispozitat e ligjeve të aplikueshme. Me propozim për gjykatën që padia dhe kërkesëpadia e paditëses M.. Sh.. të aprovet pjesërisht si e bazuar, ashtu që të detyrohet K.. Gj.. i K., që në emër të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 540.00 euro, kurse në emër të dëmit jo material shumën prej 360.00 euro, kurse në emër të përpilimit të kërkesës për kompensim dhe të përfaqësimit nga ana e avokatit, në përputhje me tarifën e Odës së Avokateve, shumën e përgjithshme prej 120.00 euro,

Gjate deklarimeve të dhëna ne seancat gjyqësore, ka theksuar se edhe më tej për të paditurën është e pa kontestueshme baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese mbetet lartësia pasi që shumat e kërkuara për tani më paditësen M.. Sh., janë tejet të larta, dhe në kundërshtim edhe me kriteret e parapara për kompensimet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.1/2023 për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose privuar nga liria. Tutje ka theksuar se paditësja pune primare ka patur punën në Spitalin e Gjilanit, kurse punë sekondare ka patur veprimtarinë e zhvilluar në formë të biznesit privat.

Në fjalën përfundimtare edhe më tej e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë andaj ka kërkuar nga gjykata që gjate vendosjes lidhur dëmin jo material, të ketë parasysh kompensimin vetëm për periudhën e privimit nga liria të paditëses si dhe kriteret për kompensim të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.1/2023 për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose privuar nga liria, ku sipas të njëjtit parashihet për çdo ditë të privimit nga liria, kompensimi të njihet në lartësi prej 15 euro. Kurse sa i përket dëmit material ka kërkuar nga gjykata që kjo e drejtë paditëses të njihet në shumën prej 1,257,64 euro, vetëm për dy muaj, aq sa ka qëndruar në arrest shtëpiak paditësja, duke shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar se paditësja e ka pasur biznesin privat gjatë tërë kohës. Kurse sa i përket kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të krijuara në procedurën penale, ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj në tërësi, duke shtuar se në kontratën e përfaqësimit të nënshkruar nga pala paditëse dhe avokati i cili ka marrë përsipër përfaqësimin e së njëjtës në procedurën penale, nuk është përfshirë shuma fikse e marrëveshjes, e cila figuron në transaksionin bankar. Tutja, në mungesë të provave materiale që do dëshmonin pjesëmarrjen në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore dhe as ndonjë procesverbal nga procedura penale, ka theksuar se duhet të refuzohet si e pa bazuar kjo pjesë e kërkesëpadisë. Në rast të aprovimit eventual, ka kërkuar nga gjykata të ketë parasysh

tarifën e aplikueshme sipas Odes së Avokateve të Kosovës për shpenzimet në përfaqësim. Pjesën tjetër të kërkesëpadisë, përtej shumave të propozuara, ka kërkuar nga gjykuara ta refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar varësisht nga suksesi në procedurë.

II. Provat Materiale të administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat; Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile, lëshuar nga MPB i datës 09.07.2019, Aktgjykimi nga Gjykata Themelore në Gjilan - DKR me nr. PKR.nr. 114/16 i datës 31.05.2017, Aktvendimi nga Gjykata Themelore në Gjilan PKR.nr. 114/2016 e datës 20.05.2016, Aktvendim Gjykata Themelore në Gjilan PKR.nr. 114/2016 e datës 23.08.2016 Aktgjykimi nga Gjykata e Apelit të Kosovës PAKR.nr.324/17 i datës 27.09.2017, Aktvendimi nga Gjykata e Apelit të Kosovës PN.nr.663/16 e datës 23.09.2016. Aktvendimi nga Gjykata Themelore në Gjilan PPr.KR.nr.50/16 e datës 21.04.2016, Aktvendimi nga Gjykata Themelore në Gjilan PPr.KR.nr.50/16 e datës 24.03.2016 Kontrata për shërbime profesionale juridike e datës 27.06.2016, Urdhëresa për deponim nga N.. Bank, në llogarinë bankare B.. e datës 17.11.2017, Fatura me numër 018/17 e datës 11.16.2017, Kërkesa për kompensim dëmi me numër 09/165 e datës 13.12.2017 për K.., oferta për ujudi nga komisioni për kompensimin e dëmit të personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pa bazë nga liria nga K.. e datës 26.02.2018, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml.nr. 331/17 i datës 27.03.2018, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ref. Nr. 60/23 e datës 27.02.2023, Certifikata e regjistrimit të biznesit me emrin O.. Gj.. "Z.." lëshuar nga ARBK, Publikimet e bëra në mediumet informatike të Kosovës, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera të lëshuar nga ATK e datës 12.05.2023, Ekspertiza financiare e datës 09.06.2023 si dhe plotësimi i datës 06.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pjesërisht e bazuar.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se në raport e paditësen M.. Sh.., është zhvilluar procedura penale për shkak të veprës penale trajtimi pandërgjegjshëm mjekësorë, nga neni 260 par.4 lidhur me par.1 të KPK-së. Paditësja cila ishte me profesion Dr. Specialiste Gjinekologe, akushere në Spitalin Regjional në Gjilan, në cilësi të shëfese së repartit të sallës së lindjeve , i është vënë në barrë vepra e lartcekur, për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve në drejtim të dhënies së tretmanit mjekësorë më kohë, që ka pasur për pasoje edhe përfundimin më fatalitet, që ka pasuar me vdekjen e pacientes e cila është mjekuar në këtë spital.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit për dëmin material dhe jo material, si dhe nëse paditësi ka të drejtë në lartësinë e shumave të

kompensimit, për të cilat palët ndërgjyqëse patën qëndrime tërësisht të kundërta deri në përfundim të këtij procesi gjyqësor.

Si rrjedhojë e procedurës së zhvilluar penale, me qëllim të sigurimit të prezencës së të pandehurës, tani në këtë procedurë paditëse, sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda PPr.KR.nr.50/2016, të datës 24.03.2016, paditëses është caktuar edhe masa e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej një muaji nga data 22.03.2016 deri me datën 21.04.2016, e cila me pas i është vazhduar sipas vendimit të gjykatës edhe për një muaj, deri më datën 21.05.2016.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan –Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.114/2016 të datës 31.05.2017, paditësja është liruar nga akuza, konform nenit 364 par.1 pika 1.3 dhe neni 454 par.1 e 463 par.3 të KPRK-së. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor pa ushtruar ankese Prokuroria Themelore në Gjilan për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të ankesës së ushtruar, përmes aktgjykimit PAKR.nr.324/2017 të datës 27.09.2017, e ka refuzuar si e bazuar ankesën e parashtruar nga Prokuroria Themelore në Gjilan dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.114/17 të datës 31.05.2017.

Si çështje tjetër e cila nuk ishte kontestuese ndërmjet ndërgjyqësve, ishte edhe çështja e përfundimit të procedurës penale, e cila kishte rezultuar me refuzimin si të pabazuar të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit të Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-DKR,PKR.NR.114/2016 të datës 31.05.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.NR.324/2017, të datës 27.09.2017.

Me leximin e Kontratës për Shërbime Profesionale Juridike e lidhur në mes të paditëses dhe av. F.. L.. nga Prishtina, të datës 27.06.2016, në pikën 3 të njëjtës, gjykata gjeti se palët nënshkruese të kësaj kontrate, janë dakorduar që për shërbimet e përfaqësimit, avokati të paguhet në përfundim të procesit gjyqësor, sipas marrëveshjes ose duke llogaritur përfaqësimin e tij në seanca gjyqësore si dhe duke marrë për bazë parashtrësit e bërë sipas tarifës së OAK-së. Sipas pikës së 5 të kontratës, është paraparë që për çdo shume eventuale të pranuar nga avokati, duhet të lëshohet fatura.

Nga Urdhëresa për Deponim/ Tërheqje, me përshkrimin M.. Sh.. pagesë për përfaqësim ligjor në rastin PPK.nr.50/16 në Gjykatën Themelore në Gjilan, gjykata gjeti se paditësja nga llogaria e saj bankare, me datën 17.11.2017, ka transferuar shumën prej 5,900.00 euro në llogarinë e përfaqësuesit të saj sipas autorizimit, i cili e ka përfaqësuar në procesin gjyqësor penal, Av. F.. L... Kurse me leximin e Faturës së lëshuar me nr.018/2017 të datës 11.06.2017, rezulton se shumën e cekur në urdhëresë për deponim, rezulton me faturën e lëshuar me përshkrimin “për shërbime profesionale ligjore”, dhe atë në shumën prej 5.900.00 euro.

Çështje tjetër kontestuese nuk ishte edhe rrethana se paditësja i është drejtuar me kërkesë për kompensim të dëmit nga arresti shtëpiak, e paditura më datën 13.12.2017, kurse Komisioni për kompensimin e dëmit te personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pabazë nga liria, më datën 26.02.2018, ka ofruar Ofertën për Ujdi , ashtu që ne emër te dëmit jo material, ka vlerësuar se shuma që duhet kompensuar është ne lartësi prej 360.00 euro, kurse ne emër te dëmit material –fitimit te humbur, shuma prej 360.00 euro, kurse ne emër te shpenzimeve te krijuara për përfaqësim ne procedurën penale, shuma prej 120.00 euro. Shuma e ofruara nga e paditura, nuk janë pranuar nga paditësja pre çka edhe me pas i është drejtuar gjykatës me padi.

Me leximin e artikujve te publikuar në mediumet e shkruara, vërtetohet edhe publikimi i artikujve lidhur me arrestimin e paditëses dhe personave tjetre për shkak te vdekjes se pacientes si dhe artikujt lidhur me protestat e zhvilluara për shkak te vdekjes se pacientes, për te cilën paditësja ishte akuzuar, duke vënë ne pah edhe kërkesat e protestuesve pre shpalljen fajtor te kryesve te veprës penale, qe kishte për pasojë vdekjen e pacientes.

Me leximin e gjendjes se përgjithshme te deklarimeve dhe transaksioneve tjera, dokument ky i lëshuar nga Administrate Tatimore e Kosovës, gjykata gjeti se i njëjti përmban te dhëna për tatimin ne burim nga biznesi individual O.. Z.. ne Gj., metë cilin biznes ka menaxhuar paditësja për ofrimin e shërbimeve ne fushën e gjinekologjisë. Periudha e përfshire ne këtë raport, përfshin periudhën nga vitin 2016 e deri ne vitin 2023. Kurse me leximin e Certifikatës se lëshuar nga Agjencia e regjistrimit te bizneseve te Kosovës, rezulton se O.. S.. Gj.. Z.. ne Gj., e cila është biznes individual, është e regjistruar ne emër te M.. Sh., dhe ky biznes është regjistruar me datën 20.05.2003 dhe ka qene aktiv deri më datën 09.06.2022.

Duke vepruar sipas propozimit te autorizuarit te palës paditëse, gjykata ka nxjerre provën me ekspertize nga lëmia financiare, dhe për ekspert është caktuar A.. C.. Ekspertja ka pasur për detyre qe bazuar ne te dhënat sipas pasqyrës se llogarisë bankare, te llogaris demin eventual, ne forme te fitimit te humbur, te cilën mund ta ketë pësuar paditësja si pasoje pamundësisë se ushtrimit veprimtarisë punuese, nga data 23.03.2016 e deri ne datën e hartimit te ekspertizës. Po ashtu detyre e ekspertes ka qene edhe përlllogaritja e kamatës ligjore për shpenzimet e krijuara ne procesin gjyqësor penal, bazuar në faturën nr.018/2017.

Ne mendimin dhe konstatimin e dhënë ne ekspertizën e datës 09.06.2023, ekspertja ka përlllogaritur se duke filluar nga data 01.04.2016 e deri me datën e hartimit te ekspertizës, 31.05.2023, borxhi total ne emër te fitimit te humbur si rezultat i pamundësisë se ushtrimit te aktivitetit rezulton 60,612.04 euro, se bashku me kamatën prej 18,110.31 euro, në shumën e përgjithshme prej 78,722.35 euro. Kurse për shërbimet profesionale juridike te krijuara ne procedurën penale, shuma e përlllogaritur e kamatës për periudhën nga data 27.06.2023 e deri më datën 31.05.2023, për borxhin kryeson ne lartësi prej 5,900.00 euro, ka arritur ne shumen prej 9.171.28 euro. Meqenëse ekspertja nuk ka përlllogaritur fitimin e humbur sipas detyrave te caktuara nga gjykata, ne plotësimin e ekspertizës financiare te datës 06.12.2023, ekspertja duke u bazuar ne mesataren e qarkullimit te tri viteve paraprake, për periudhën nga data 23.03.2016 e deri më datën 06.12.2023, si date e hartimit te ekspertizës, fitimin e humbur e ka llogaritur ne lartësi prej 56,113.64 euro, kurse llogaritja e kamatës ligjore për periudhën e njëjte kohore, ne

lartësi prej 18,798.51 euro. Kurse lartësia e fitimit të humbur për ditët e arrestit shtëpiak, në kohëzgjatje prej 60 ditësh sipas ekspertës është llogaritur në lartësi prej 1,241.31 euro, me kamatën ditore prej 0,2 %, në shumën e përgjithshme prej 1,257.64 euro .

Pas pranimit të plotësimit të ekspertizës financiare, i autorizuari i paditëses e ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë ashtu që në emër të demit material në formë të fitimit të humbur, ka kërkuar nga e paditura shumën prej 56,113.64 euro, në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurën penale, shumën prej 5,900.00 euro, kurse në emër të demit jo material për shkak të cenimit të reputacionit profesional dhe personal shumën prej 20.000 euro, në shumën e përgjithshme për të gjitha format e demit 82,013.64 euro/cent, me kamate ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të kërkesës së drejtuar K..-së më datën 13.12.2017 e deri në përmbushjen definitive.

III. Ligji i zbatueshëm

Të drejtën e kompensimit të personave të mbajtur, arrestuar dhe paraburgosur pa arsye e parashih edhe Konventa Evropiane për të Drejtat, e cila ka aplikim direkt në Kosovë, duke u integruar përmes nenit 22 par. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas nenit 5 par. 5 të kësaj Konvente “Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”.

Kurse sipas neni 185 paragrafi 1i të njëjti ligj përcakton:” *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Lidhur me paragrafin 3:”Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit. Kurse sipas neni 189, i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar.*

E drejta e kompensimit të personave të paraburgosur pa të drejtë, rregullohet sipas Vendimit të K.. Gj.. mbi Kriteret e Përgjithshme për Kompensimin e dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye datë 03.07.2007 (i aplikuar në kohën kur paditësi është privuar nga liria), lidhur me dëmin jo material, neni 5 i këtij vendimi parashikon: *Dëmi jo material/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës së përjetuar, ndjenjës së turpit, shuma e përcaktuar e kompensimit është 180€ në muaj për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye/paraburgosur.*

Po ashtu një e drejtë e tillë parashihet edhe me nenin 529 të Kodin të Procedurës Penale të Kosovës, sipas të cilit: *E drejta e kompensimit të dëmit i takon personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar.*

Gjithashtu aplikoi dispozitën nga neni 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (i aplikuar në kohën kur paditësi ishte në kufizim të lirisë, pra në kohën kur ka ndodhur dëmi), sipas se cilës dispozitë *“kush i shkakton dëm tjetrit është i detyruar t’ia kompensoj për deri sa te mos provoj se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, gjykata konsideron se e paditura në rastin konkret duhet ta korrigjoj demin e shkaktuar paditësit me paraburgim të pa drejtë, pasi paditësi me aktgjykim është liruar nga akuza.

Kurse për sa i përket kategorisë së kompensimit të dëmit jo material gjykata ka aplikuar nenin 183 par 1 të LMD, sipas të cilit *Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Kurse në paragrafin 2 të këtij neni parashihet *Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.**

IV. Përkitazi me shumat e gjykuara

4.1 Lidhur me kërkesëpadinë për kompensimin e dëmi jo material

Gjykata vlerëson se tek ky rast përmbushen elementet e lidhjes kauzale në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar Gjykata arriti në përfundim se privimi i kundërligjshëm i lirisë së paditëses për 60 ditë, ka ndodhur pa fajin e paditëses kurse si pasojë e këtij privimi asaj i është shkaktuar dëm, e që në rastin konkret konsiston në dëmin jo material mbi frikën e përjetuar, degradim personalitetit, dinjitetit, cenim ndaj nderit, të drejtave dhe lirive themelore njerëzore, të cilat kanë ndikuar me pasoja si në jetën, personale, profesionale, miqësore dhe shume relacione tjera njerëzore. Lidhur me këtë pretendim gjykata vlerëson se koha e kaluar në arrest shtëpiak, i jep të drejtë paditëses që të kërkoj kompensim të dëmit jo material për ditët e kufizimit të lirisë.

Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara për paditësen paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar nga ajo gjatë kohës së qëndrimit në arrest shtëpiak, dhimbjet shpirtërore dhe frikës së përjetuar të paditësit, e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform dispozitave nga neni 322 dhe 323 të LPK-së si dhe nenit 183 të LMD-së, si dhe duke pasur si orientim kriteret dhe masat e vëna nga praktika gjyqësore lidhur me lartësinë e dëmeve jo materiale, posaçërisht lidhur kompensimet e kësaj natyre, në ndërlidhje me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023. Po ashtu

me rastin e vendosjes për vlerën e kompensimit ka marrë parasysh edhe rrethanat tjera që janë ndikuar, siç janë kohëzgjatja e qëndrimit në arrest shtëpiak, natyra e veprës për të cilën ka qenë akuzuar, moshën e paditëses, profesionin dhe rrethanat familjare të tij. Deri te lartësia e kompensimit për këtë formë të dëmit, gjykata pati parasysh edhe cenimin e te drejtave dhe përjetimeve të paditëses të cilat nuk mund të jene të shkallës së njëjtë sikur paditëses ti caktohej masa e paraburgimit.

Andaj, në këtë kuptim, Gjykata duke vepruar konform përcaktimeve të dhëna nga Udhëzuesi i lartcekur, i cili parasheh se nuk ka arsye për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë pasi vuajtjet janë evidente dhe nuk ka nevojë të provohen me ekspertizë, ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë. Përfundimisht sipas këtij udhëzues nxjerrja e kësaj prove parashihet vetëm kur i dëmtuari ka histori të trajtimit mjekësorë të aspektit psikiatrik, siç nuk është në rastin konkret me paditësen, pasi që e njëjta nuk ka ofruar ndonjë provë materiale për gjykatën që dëshmon se ka pranuar shërbime në këtë drejtim.

Gjykata vlerësoj pretendimet e të paditurës në lidhje me atë se gjykata në lidhje me përcaktimin e lartësisë së kompensimit të vendosë sipas Udhëzimit Administrativ 01/2023 të KGJK-së, për procedurën për kompensimin e demit e personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, por gjykata të njëjtat pretendime nuk i mori për bazë. Kjo për faktin se sipas Udhëzimit Administrativ në nenin 14.4 parasheh që nëse pala nuk pajtohet me shumën e ofruar nga ana e komisionit, ajo fiton të drejtën që në procedurën e rregull gjyqësore, me padi civile të kërkojë kompensimin e dëmit për të cilën pala pretendon se i takon. Në rastin konkret paditësja ka vepruar sipas udhëzimit, por nuk është pajtuar me shumën e ofruara për kompensim nga komisioni dhe kjo vërtetohet nga ofertën e dhënë nga e paditura dhe me paraqitjen e padisë pranë gjykatës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e dhënë *V. dhe B. kundër Rusisë* (2018), lidhur me kompensimin e personave të dënuar pa arsye, ka sqaruar se nuk ekziston ndonjë standard me të cilën dhimbjet shpirtërore, shqetësimi psikologjik dhe ankthi mund të maten në një kundërvlerë të saktësisht të matshme të parave. Më tej Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përmes këtij vendimi ka thënë se vlerësimi nga ana e gjykatave të shumave të matshme të kompensimit, duhet të bëhet duke u bazuar në kritere të qëndrueshme të cilat duhet të marrin parasysh standardin e jetës të vendit. Sido që të jetë, Gjykata Evropiane ka theksuar se nuk mund të lejohet një shumë tejet e ulët e kompensimit, e cila do të ishte aq e ulët saqë do të *minonte* frymën e vërtetë të nenit 5.5 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, ngase do të humbiste thelbin e zbatueshmërisë së këtij neni, i cili garanton të drejtën e kompensimit të personave të dënuar apo paraburgosur pa arsye.

Së këndejmi gjykata vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me praktikën e krijuar gjyqësore të gjertanishme, andaj ka refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara, shumën prej 18,200.00€, duke iu referuar Udhëzimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023.

4.2 Lidhur me kërkesëpadinë për kompensimin e dëmit material në emër të fitimit të humbur

Për sa i përket pjesës së kërkesëpadisë me të cilën është kërkuar kompensimi i dëmit material për ditët e humbura të punës gjatë privimit nga liria, nga data 22.03.2016 deri më datën 21.05.2016, paditësit i është njohur shuma prej 1,257.64 euro. Kjo mënyrë e vendosjes arsyetohet me faktin se paditësja, është e legjitimuar të kërkoj shpërblimin e dëmit material në formën e fitimit të humbur vetëm për periudhën sa ka qëndruar në arrest shtëpiak, dhe jo për periudhën pasuese, kur veprimi i kundërligjshëm i të paditurës është ndërprerë. Së këndejmi paditësja nuk ka ofruar asnjë provë materiale që për periudhën sa ka qenë e privuar nga liria, të ketë pësuar dëm material në formën e fitimit të humbur, pasi që edhe nga provat materiale, është vërtetuar se paditësja ka vazhduar zhvillimin e veprimtarisë së saj private, në biznesin e udhëhequr nga ajo, edhe pas periudhës së privimit nga liria. Së këndejmi këtë punë e ka pasur punë sekondare, pas që angazhimi primar i saj ka qenë në Spitalin e Gj., ku është ka qenë e angazhuar në kohën kur ka ndodhur vepra penale, për të cilën është ngarkuar sipas aktakuzës.

4.3 Lidhur me kërkesëpadinë për kompensimin e dëmit material për shpenzimet e krijuara në procedurë penale

Gjykata vendosi si në dispozitivin e I (një) pika (c) duke aprovuar kërkesëpadinë në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurë penale në emër të mbrojtjes nga avokati, si dëm material, shumën prej 5, 900.00 €, ngase nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, si aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.114/16, të datës 31.05.2017, si dhe aktvendimi PPr.KR.nr.50/16 i datës 21.04.2016, vërtetohet se pala paditëse është përfaqësuar nga av. F.. L... Kurse sipas Kontratës për Shërbime Profesionale Juridike e lidhur në mes të paditëses dhe av. F.. L.. nga P., të datës 27.06.2016, në pikën 3 të njëjtës, gjykata gjeti se palët nënshkruese të kësaj kontrate, janë dakorduar që për shërbimet e përfaqësimit, avokati të paguhet në përfundim të procesit gjyqësor, sipas marrëveshjes ose duke llogaritur përfaqësimin e tij në seanca gjyqësore si dhe duke marrë për bazë parashtrirat e bere sipas tarifës së OAK-së.

Me nenin 30 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet: “çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim: të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikoj lirisht me të dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, ti sigurohet mbrojtja falas.

Me nenin 57 par.1 të KPPRK-së parashihet:” i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar: nënpar.1.2:” gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; nënpar.1.3:” nga ngritja e aktakuzës, kur është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë burgim”.

Lartësinë e shpenzimeve në emër të mbrojtësit-avokatit, gjykata e ka kalkuluar duke u bazuar në Urdhëresa për Deponim/ Tërheqje, me përshkrimin M.. Sh.. pagesë për përfaqësim ligjor në rastin PPK.nr.50/16 në Gjykatën Themelore në Gjilan, nga e cila rezulton se paditësja nga llogaria e saj bankare, me datën 17.11.2017, ka transferuar shumën prej 5, 900.00 euro në llogarinë e përfaqësuesit të saj sipas autorizimit Av. F.. L.. Kurse me leximin e Faturës së lëshuar

me nr.018/2017 të datës 11.06.2017, rezulton se shuma e cekur ne urdhëresë për deponim, rezulton me faturën e lëshuar me përshkrimin “për shërbime profesionale ligjore”, dhe atë në shumën prej 5.900.00 euro, gjë që vërtetohet se e njëjta është mbrojtur nga avokat. Kurse lëshimi i faturës ishte paraparë edhe sipas pikës se 5 të kontratës të lidhur mes paditëses dhe av. F. L., ku për çdo shume eventuale të pranuar nga avokati, është paraparë të lëshohet fatura. Fakt ky jo kontestues nga e paditura, megjithëse për të paditurën kontestuese ishte mos argumentimi me prova materiale i seancave të mbajtura.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se vepra penale për të cilën paditësja ka qenë e akuzuar ka qenë me dënueshmëri të lartë, dhe për faktin se paditësja gjatë gjithë fazave të procedurës penale ka qëndruar në arrest shtëpiak, dhe mbi bazën e këtyre rrethanave mbrojtja ka qenë e detyruar dhe sikur vet paditësja të mos angazhonte mbrojtës me shpenzime të tij, ka qenë obligim i gjykatës që të caktoj mbrojtës me shpenzime publike në kuptim të nenit 57 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së. Së këndejmi ne shpenzimet gjyqësore, nuk hyjnë vetëm pjesëmarrja ne seanca gjyqësore, por edhe përpilimi i parashtresave te nevojshme dhe ndërmarrja edhe veprimeve tjera varësisht nga nevoja që kërkohet nga një procedure e cila është në zhvillim e sipër.

Andaj Gjykata si shpenzim të avokatit mbrojtës i ka llogaritur në lartësi prej 5,900.00 euro, pasi që paditësja ka argumentuar me prova materiale se detyrimet sipas kontratës i ka zbatuar dhe atë në shumë aq sa është kërkuar si ne padi.

Së këndejmi, Gjykata gjatë vendosjes pati parasysh se lidhur me këtë kategori të dëmit pala paditëse përkundër faktit te mos prezantimit te provave materiale për seancat e mbajtura, ka prezantuar fatura përmes të cilës është vërtetuar se është bërë pagesa e mbrojtësit, kurse nisur nga praktika tanimë e krijuar gjyqësore, shpenzimet e përfaqësimit në procedurat gjyqësore si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale, u janë njohur palëve, edhe ne mungesë të prezantimit të faturave, por me vetë faktin e përfaqësimit të palës me avokat në seancë, e cila në rastin konkret është provuar nga paditësja,

Së këndejmi Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar duke siguruar që kompensimi të jetë saktisfakcion për paditësen dhe shmangur qëllimet tjera materiale – lukrative që mund të bien ndesh me *Vendimin mbi kriteret e përgjithshme për kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye*” dhe me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Në këtë kuptim gjykata ia fali pjesërisht besimin ekspertizës financiare, për pjesën e aprovuar te kërkesëpadiisë, që i referohet përlllogaritjeve të bërë nga ekspertja sa i përket shpenzimeve të avokatit mbrojtës, (ku është përlllogaritur edhe kamata ligjore mbi borxhin kryesor) si dhe shpenzimeve në emër te fitimit te humbur për periudhën e qëndrimit ne arrest shtëpiak te paditëses, andaj në këtë pjesë te njëjtës ia fali besimin duke e vlerësuar si profesionale dhe mire te argumentuar për arsyet e dhëna si më lartë.

Gjykata vlerësoj provat tjera materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Lidhur me kërkesën për kamatë, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroi të paditurën që paditëses në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën duke llogaritur për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit më datën 07.03.2024 kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë më datën 17.07.2019 në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme lidhur me kamatën.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve i referohet shumës për përpilimin e padisë 104€, për taksë për padi 150€, për dy seanca gjyqësore shumën 270 € (135x2), për ekspertizën financiare 150.00 €, apo në shumë të përgjithshme 524.00 €, pasi këto janë shpenzime proporcionale me suksesin e palës në procedurë, ngase kërkesëpadia e paditësit është aprovuar pjesërisht. Kurse në shpenzime procedurale nuk janë llogaritur shpenzimet e krijuara për një seancë gjyqësore të mbajtur pranë kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2410/2019 datë 07.03.2024.

Gjyqtarja

Rezarta Sylejmani- Voca

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.